



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.20, datë 05.04.2024

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT, NDRYSHIMIN E
SUBJEKTIT ZHVILLUES DHE SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “KOMPLEKSI TURISTIK “THYMUS”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI,
BASHKIA HIMARË”

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues, shoqëria “Drimadhe I & I” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit, ndryshimin e subjektit zhvillues dhe shtyrjen e afatit të Lejes së Ndërtimit miratuar me Vendimin Nr. 26, datë 10.06.2021 “Kompleksi Turistik “Thymus”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Drimadhe I & I” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin Nr.26, datë 10.06.2021 zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 03/06 2024